



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Broshurë,
3-mujori i dytë,
2022

Përgjegjësia Sociale e Korporatave

Prill - Qershor 2022









- Mbështetëse e edicionit të 5-të të Swing Marathon, mbajtur në 30 prill 2022, në Shkodër.
- Në kuadër të luftës kundër diskriminimit, mbështeti për të pestin vit radhazi “Mbrëmjen Gala të Bamirësisë”, të organizuar në Tiranë në datën 31 maj 2022, nga aktivistët e komunitetit LGBT. Misioni i këtij eventit ishte sigurimi i fondeve për vazhdimësinë e akomodimit, ushqimit, mbështetjes psiko-sociale, aftësimin për jetën, edukimin dhe punësimin për të rinjtë LGBT, të cilët janë viktimë të abuzimit dhe diskriminimit dhe jetojnë pranë Qendrës “Streha”.
- Në kuadër të festivalit Gjon Mili dhe Javës Amerikane në Korçë, banka mbështeti “videoLAB” në Muzeun Gjon Mili, një laborator i pajisur me mjetet e domosdoshme për të rinjtë e pasionuar në video art dhe fotografi.
- Mbështet Fondacionin Spitalor të Nënës dhe Fëmijës në projektin “Kutia e Gëzimit” për një periudhë 1 vjeçare, duke i dhuruar paketa për bebet e porsalindura nënave nga shtresat vulnerabël në të gjithë vendin.
- Në 16 qershor 2022 u zhvillua Ankandi i Dhurimit “Rrathë Dhurues 2022” nga “Partnerët Shqipëri” duke ofruar mbështetje financiare për 3 kauza. Banka Amerikane e Investimeve ofroi mbështetje për dy prej kauzave të prezantuara: “Pop-

up book!” një iniciativë që do të kontribuojë në krijimin e një hapësirë miqësore, letrare, dhe novatore në mjediset e shkollës “Ferraj”, e cila frekuentohet nga 148 nxënës, dhe “Nadja e mirë gjyshërit tanë!” iniciativës që do të kontribuojë në ndërtimin e një hapësirë rekreative për moshat e treta në qytetin e Shkodrës.

- Me rastin e muajit të Ramazanit dhe festës së Bajramit, banka iu përgjigj kërkesës së Kryqit të Kuq dhe Komunitetit Mysliman Shqiptar për dhurimin e 150 paketave me produkte ushqimore, në mbështetje të familjeve më në nevojë të qytetit të Tiranës.



- Në kuadër të bashkëpunimit me Federatën Shqiptare të Basketbollit, mbështeti Summer Tour 3X3 i cili është një aktivitet që zhvillohet nga Federata në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë.
- Mbështeti ekspozitën me titullin Acta Urbana të artistit, krijuesit dhe dizajnerit grafik Petraq Papa, e cila u çel në 9 qershor 2022 pranë galerisë FAB. Ekspozita ishte rezultat i një pune të gjatë gati 10-vjeçare të autorit, me krijimin e një numri të madh të pullave filatelike, monedhave numizmatike dhe kartëmonedhave, dy prej të cilave janë aktualisht të




pranishme në tregun shqiptar, përkatësisht ato me vlerë 2 000 Lek (Mbreti Gent) dhe së fundmi emetimi i kartëmonedhës 10,000 Lek (Asdreni) emetim i Bankës së Shqipërisë.

- Mbështeti Qendrën Shqiptare për Zhvillimin e Familjes (ACFD) për Giving Circle Albania 2022, mbajtur më 16 qershor 2022 në mbështetje të tre kauzave që do të sjellin ndryshime të qëndrueshme sociale për komunitetet në nevojë. BKT mbështeti projektin “Fëmijë të shëndetshëm - komunitet i shëndetshëm!”.
- Në bashkëpunim me DSIK Albania dhe AAB, mbështet nismat për edukimin financiar tek brezi i ri. Gjatë vizitës në disa shkolla të kryeqytetit u zhvilluan trajnime në formë loje për njohuritë bazë rreth financave.
- Mbështeti Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës në organizimin e konkursit Young Innovators më datë 18 maj 2022, në kuadër të përmblylljes së lëndës së inovacionit. Të pranishëm ishin rreth 250 studentë të vitit të tretë në degët e Administrimit Biznesit dhe Informatikës Ekonomike; Dekani i Fakultetit të Ekonomisë; pedagogë të departamenteve respektive; përfaqësues nga Bashkia e Tiranës dhe institucione të tjera.
- Banka bashkëpunoi me Kryqin e Kuq Shqiptar dhe nën sloganin “Dhuro gjak, shpëto jetë!”, dhe u ndodh pranë personave që kanë nevojë për gjak.



- Tradita e Food Bank vazhdon e shtrihet anë e mbanë Shqipërisë. Ndhima e radhës ka qenë për organizatën jo fitimprurëse Papa Xhovani XX III në Shkodër ku janë dhuruar 30 pako ushqimore si dhe mobilie për të përmirësuar ambientet e personave të cilët kjo organizatë ndihmon. Banka u gjend edhe në rajonin e Vaut të Dejës duke dhuruar edhe aty 30 pako ushqimore si dhe në rajonin e Sarandës duke dhuruar 60 pako me ndihma.
- Në Panairin Agro në Lushnjë, punonjësit e bankës, duke përdorur edhe degën lëvizëse, informuan fermerët e zonës duke i ofruar alternativat më të mira, si dhe ndihmuam banorët e zonës me shërbime bankare.
- Bashkëpunoi me Kryqin e Kuq Shqiptar në dhurimin vullnetar të gjakut për fëmijët talasemikë.
- Një ndër partnerët në organizimin e Konferencës Kombëtare të Shkencave Mjekësore 10 me mbi 500 lektorë dhe 100 profesorë të huaj.
- Mbështeti konkursin “Forumi i Studenteve të Financës”, ku studentët e Universitetit Evropian të Tiranës konkurruan me idetë e tyre në lëndën “Tregjet Financiare”. Tema për këtë vit ishte “Green Economy and Financial Challenges”, ku u ndanë çmime për fituesit si dhe u dha një mundësi për praktikë pune pranë bankës Credins.
- Mbështeti organizimin e Tirana Economic Forum, më datën 10 maj 2022.



- Mundësoi pajisjen me kompjuter, fotokopje, toner, printer për të lehtësuar proceset e punës në disa institucione, si: Shkolla 9-vjeçare “Lidhja e Prizrenit”, Zyra Vendore Arsimore Fier, Shkolla 9-vjeçare “Edit Durham”, Drejtoria Rajonale e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Shkodër, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, dhe Qendra Shëndetësore e Specialiteteve Nr.1 Tiranë.
- Mundësoi mobilimin e mjediseve në institucionet: Institucioni Arsimor 9-vjeçar “Foto Puka” Lushnje - Drejtoria Arsimore Lushnje, Qendra Shëndetësore Dushk-Lushnje, Qendra Shëndetësore Hysgjokaj-Lushnje, Qendra Shëndetësore Bubullimë, Qendra Shëndetësore Nr. 8 Tiranë, Reparti Ushtarak Nr. 4001, Kopshti Nr. 31.
- U dhurua pajisje EKG për Spitalin Rajonal Shkodër.
- Dhuroi një sobë profesionale për Qendrën Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët.
- Qendra Shëndetësore Nr. 2 Berat: në restaurimin e degës dhe përmirësimin e ambienteve.
- Komisariati Rajonal i Policisë Rrugore: me mjete logjistike në ndihmë të institucionit.
- Mbështeti Bashkinë Durrës dhe mundësoi mbjelljen e disa pemëve për t’i dhënë gjelbërim qytetit.
- Mundësoi ndërtimin e parqeve të lojërave për fëmijët në Shkozë në Lana Bregas dhe në Lushnje.
- Banka Credins pjesëmarrëse në disa panaire, si: Panairi i Punës “Work and Study” organizuar nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë; Panairët e Punës organizuar tek universitetet: Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës; Universiteti “Aleksandër Moisiu”; Universiteti “Epoka”; Universiteti “Marin Barleti”; Universiteti European i Tiranës; Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.
- “Konkursin e Bizneseve të Gjelbërta”, në bashkëpunim me Partners Albania for Change and Development. Gjithashtu, banka u ofroi një ditë trajnim online aplikantëve të konkursit që ishin të interesuar për të mësuar më shumë rreth “Marketing dhe Promocion”.
- Credins Bank edhe këtë vit ishte pjesë e ankandit të dhurimit “Rrathë Dhurues”, të organizuar nga Partners Albania for Change and Development, ku mbështeti kauzën “Fëmijë të shëndetshëm, komunitet i shëndetshëm”.
- Banka mbështeti disa veprimtari artistike:
 - » Koncerti i artistit Olen Cesari.
 - » Koncerti Gala “60 vjetori i Fakultetit të Muzikës”.
 - » Tirana Art Fest 7.
 - » Qyteti im Evropian organizuar nga ABC Tirana Club, në qytetin e Korçës.
 - » Aktivitetin paragliding “Albania Open” nga Aeronautika Shqiptare”.
 - » Edicionin e 6-të të Festivalit të Riteve 2022 në Gjirokastrë, nga Qendra Kulturore Mediatike




Antigonea.

- » Konferencën “Mjeshtëro Biznesin”: me pjesëmarrje kryesore të z. Vasil Naçi, si dhe sipërmarrësve, pedagogëve apo profesorëve në fusha e industri të ndryshme.
- » Tirana International Watercolor Festival” nga VIZart.
- » Maratonën “Tiranaolon”.
- » Dibra N’Fest.
- » Ekspozitat e pikturës pranë degës qendrore të piktorëve Genc Përmeti dhe Vjola Terolli.
- » Festivalin “Animals and Friends”.
- » Koncertin e këngëtarit Janis Parios.
- » Koncertin koreografik nga International Dance Academy Albania (IDAA).

ose që prodhojnë produkte dhe shërbime për gratë. Në bashkëpunim me projekte të ndryshme ky produkt mbështet edhe financimin e aktivitete start – up.


- Mbështet realizimin e projektit “Të Sigurt për në Shkollë, Të Sigurt për në Shtëpi” nga Kryqi i Kuq Shqiptar, Dega Tiranë, i cili ka për qëllim edukimin e fëmijëve me rregullat e qarkullimit rrugor.
- Në 6 maj 2022, u organizua Panairi i Punës me qëllim krijimin e mundësive për zhvillimin e praktikës për studentët e Fakultetit të Ekonomisë, nivel bachelor dhe master. Fibank i mundëson ndër vite studentëve të interesuar për të zhvilluar praktikën studentore, duke u mundësuar dhe punësimin në pozicione vakante.
- Banka mbështeti Panairin e Punës 11, organizuar më 10 qershor 2022, nga Fakulteti Ekonomik në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, në bashkëpunim me ABSL Albania (The Association of Business Service Leaders in Albania).



- Stafi i bankës, në bashkëpunim me Digital Academy Albania, zhvilloi një trajnim transformues, në 5 prill 2022, mbi rritjen e prezencës, komunikimin digjital dhe strategjive për të edukuar më shumë klientë, krijuar marrëdhënie efektive me ta, dhe gjeneruar vazhdimisht shitje.
- Në prill 2022, Fibank lancoi “Programin Smart Lady”, dedikuar për bizneset (persona fizikë ose kompani) në pronësi ose të drejtuara nga gra,



- Pjesëmarrëse në disa panaire të organizuar në bashkëpunim me disa universitete: Panairi i Punës dhe Karrierës tek Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, më 15 prill; Panairi i Punës, organizuar nga Fakulteti Ekonomik i



Tiranës, më 29 prill; Panairi i Karrierës organizuar nga Universiteti Epoka, më 18 maj.

- Banka ftoi të gjithë kolegët të merrnin pjesë në konkursin e brendshëm lidhur me Eurovision Song Contest 2022, organizuar nga Intesa Sanpaolo Bank Divisions.
- Ne datë 21 maj 2022, përfaqësues të Intesa Sanpaolo Bank Albania morën pjesë në "Open Day", një event i organizuar në ambientet e Universitetit "Zoja e Këshillit të Mirë", ku u realizua një prezantim i degëve universitare të cilat do të mund të përzgjidhen nga maturantët gjatë vitit akademik 2022-2023.
- Më 26-27 maj 2022, u organizua dhurimi vullnetar i gjakut pranë ambienteve të bankës.
- Në datën 31 maj 2022, znj. Ediola Bicaku, Drejtore e Auditimit të Brendshëm në Intesa Sanpaolo Bank Albania prezantoi një leksion të hapur në ambientet e Universitetit Epoka, me temën "Roli i Auditimit të Brendshëm dhe rëndësia e tij", organizuar në kuadër të Muajit Ndërkombëtar të Ndërgjegjësimit për Auditimin e Brendshëm nga departamenti i bankës dhe financës i Universitetit Epoka në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Bankave (AAB).
- Në bashkëpunim me Intesa Sanpaolo Bank Divisions, u organizua për herë të parë në vendin tonë nga data 1 deri më 3 qershor 2022 Kampin e

Futbollit ATALANTA. Ky kamp futbollit i ofroi një mundësi të veçantë 120 fëmijëve nga familje në nevojë, familje të klientëve të bankës dhe fëmijëve të stafit, të stërviten nga trajnerët më të mirë të skuadrës së të rinjve të Atalantës së bashku me trajnerët shqiptarë.

- Banka iu bashkua aktiviteteve të "New Vision" dhe më 6 qershor 2022 u organizua në ambientet e Zyrës Qendrore, një vizitë studimore me temë "Sipërmarrësi për një ditë".
- Banka mbështeti konkursin "Inovatorët e Rinj2 me pjesëmarrjen e 250 studentëve, organizuar nga Universiteti i Tiranës në 10 qershor 2022.
- Banka ndërmori fushata ndërgjegjësimit dhe promovon ditët ndërkombëtare.
 - » Dita Botërore e Ndërgjegjësimit për Autizmin, 2 prill.
 - » Dita Ndërkombëtare e Ndërgjegjes, 5 prill.
 - » Dita Botërore të Shëndetit, 7 prill. Intesa Sanpaolo Bank Albania, si pjesë e Grupit Intesa Sanpaolo, iu bashkua fushatës #withEARTH, duke mbështetur veprimtarinë e WWF-it për të parandaluar zhdukjen e mëtejshme të biodiversitetit. Pjesë e kësaj fushate ishte përdorimi i funksionalitetit #withEarth në platformën digjitale "Digital Banking" tërësisht online. Si rezultat i kësaj fushate Grupi Intesa



Sanpaolo ka dhuruar një shume prej 102,000 euro për të mbështetur WWF në ruajtjen e biodiversitetit.

- » Dita Botërore për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, 28 prill.
- » Ditën Ndërkombëtare të Vajzave në TIK, 28 prill.
- » Dita Ndërkombëtare e Punëtorëve, 1 maj.
- » Dita Ndërkombëtare e Diversitetit Kulturor për dialog dhe zhvillim, 21 maj.
- » Dita Ndërkombëtare e Familjes, 15 maj.
- » Dita Botërore kundër Duhanit, 31 maj.
- » Dita Botërore e Mjedisit, 5 qershor. Banka linçoi një kuiz përmes platformës së bankës e-learning. 5 fituesit e parë të kuizit u ftuan të shijojnë një darkë me CEO-n e bankës, z. Alessandro D’Oria.
- » Dita Botërore e Dhuruesit të Gjakut, 14 qershor.
- » Dita Ndërkombëtare Kundër Gjuhës së Urrejtjes, 18 qershor.
- » Dita Botërore e Refugjatëve, 20 qershor.

komunitetit, banka mundësoi krijimin e hapësirave rekreative dhe një këndi lojërash në lagjen “30 vjetori” në Berat.

- Në datat 29 prill – 3 maj mbështeti edicionin e 5-të të “South Outdoor Festival”, i cili u mbajt në Borsh.
- Për të 10-in vit në radhë banka mbështeti nxitjen e inovacionit si sponsor i përgjithshëm i konkursit mbarëkombëtar “Albanian ICT Awards 2022”. Rrugëtimi i këtij edicioni u finalizua me datë 11 qershor me një mbrëmje Gala, ne të cilin Raiffeisen u vlerësua me çmimin e Mirënjohjes. Risia e këtij edicioni ishte çmimi në vlerën 5,000 Euro për kategorinë “Inovacioni i Vitit” ofruar nga Raiffeisen, fitues i te cilit u shpall projekti “Droni i Parë Shqiptar” i kompanisë Skaitech.
- Prej 12 vitesh në bashkëpunim me Forumin e Mendimit të Lirë, korpusin e vullnetareve dhe stafin e bankës ndërmori disa aksione në zonat bregdetare të Spillesë, Velipojës, Tales dhe Zvërnecit. Me rastin e Ditës së Tokës më 22 prill, stafi i zyrave qendrore të Raiffeisen Bank ka ndaluar printimet përgjatë ditës.
- “Kursimi apo investimi – kur është koha?” është edicioni i katërt i programit studentor “Edukimi ekonomik dhe financiar i publikut”, organizuar nga qendra studentore ABC



Pjesë e Grupit RBL

- Në vijim të mbështetjes së projekteve në ndihmë të

Tirana Club dhe mbështetur nga Raiffeisen. Për të folur mbi gjetjet e këtij projekti më 10 maj u mbajt një forum diskutimi me ekspertë, studentë dhe pedagogë në ambientet e fakultetit të Ekonomisë.

- “Njihuni me paranë 2” është projekti në bashkëpunim me shoqatën ISP Albania. Pas suksesit të edicionit të parë, ku u trajnuan mbi 270 nxënës në 3 gjimnaze në kryeqytet ka filluar edicioni i dytë i cili do të shtrihet në 5 gjimnaze të tjera.
- Banka i prezantoi studentëve programet që ofron për ta: në Panairin e Punës dhe Karrierës; në Universitetin Metropolitan të Tiranës; në Universitetin Epoka; dhe në Panairin e Punës dhe Karrierës pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi” në Shkodër.
- Mbështeti festivalin “E ardhmja dhe shpresa”, më 1 qershor.
- Stafi i Raiffeisen Bank, në datë 16 qershor, organizoi aktivitetin “Embrace” me të ftuar përfaqësuesit e shoqatave që mbështesin kauzën e komunitetit LGBTQI+ në një Open Talk.
- Raiffeisen Bank si pionier i inovacionit dhe ESG në bashkëpunim me Kongresin Kombëtar të Rinisë organizoi në datat 25 dhe 26 maj ESG Innovation BOOTCAMP. Më shumë se 50 pjesëmarrës në 10 skuadra mbështetur

nga trajnues dhe mentorë të bankës, arritën t’i jepnin formë ideve deri në një prototip që u prezantua në fund të ditës së dytë para jurisë dhe shumë të ftuarve të tjerë. Skuadra që fitoi si ideja më e mirë ishte “Tiron Parking”, një aplikacion që ofron një mënyrë alternative për të paguar për parkimin në rrugët e Tiranës.



- Banka mbështeti projektin e “#you/th meant for greatness” udhëhequr nga shoqata World Vision, i cili kishte në fokus organizimin e klasave mësimore pas-shkollore për fëmijët dhe të rinjtë në nevojë të shkollës “Ibrahim Basha” në qytetin e Tiranës. Programi filloi në datën 5 maj dhe zgjati deri në përfundim të vitit shkollor, qershor 2022. Orët pas-shkollore që u organizuan ishin në lëndët gjuhë shqipe, letërsi dhe matematikë. Gjithashtu, në kuadër të këtij bashkëpunimi banka sponsorizoi pagesat e pesë mësuesve që zhvilluan orët mësimore për disa grupe nxënësish të niveleve të ndryshme, blerjen e bazës materiale (mjete mësimore) si dhe ushqime për t’u konsumuar nga nxënësit që morën pjesë në këtë program.




- Banka OTP Albania ishte mbështetëse dhe pjesëmarrëse e organizimit të “Tirana Economic Forum IV”, i cili u mbajt në datën 10 maj 2022.
- Dha kontributin e saj në qytetin e Durrësit, në mbjelljen e disa rrënjëve pemë të llojit rrap. Pemët, të cilat u mbollën në një ndër rrugët kryesore në qytet, ndihmuan në rehabilitimin e hapësirave të gjelbra përgjatë saj.
- Në datat 19-21 maj, 2022 në qytetin e Lushnjës u zhvillua Panairi i Ditëve të Agrikulturës. Ditët e Bujqësisë 2022, me qëllimin për të mbështetur zhvillimin e sektorit të bujqësisë, ofroi mundësi të shkëlqyera për bizneset dhe profesionistët e sektorit, ku morën pjesë kompanitë më të mëdha dhe aktorët më të rëndësishëm të sektorit nga Shqipëria, Ballkani dhe Evropa, midis tyre edhe Banka OTP Albania. Pjesë e standës ishin edhe 2 pemë të llojit ulli, të cilat pas përfundimit të panairit u dhuruan për Bashkinë Lushnjë.
- Shkolla “Enver Qiraxhi” në Pogradec është sponsorizuar nga OTP Albania për bazën materiale të stafit duke realizuar në këtë mënyrë një objektiv arsimor të suksesshëm, më tepër praktikë profesionale dhe kryerjen me cilësi të detyrimit pedagogjik. Kontributi i OTP

Bank Albania konsistoi në dhurimin e kompjuterëve, mjeteve të printimit dhe uniformave të punës që i nevojiten shkollës.

TIRANA BANK

- Tirana Bank mbështeti edicionin e 10-të të Konkursit “Ide për Biznese të Gjelbra”, organizuar nga Partnerët Shqipëri. Tre prej fituesve, përkatësisht: Shebenik Egnatia Explorers; Alpaca Educative Toys; dhe Funky Cabins – Glamping, do të bëhen automatikisht pjesë e konkurrimit në nivel rajonal të Konkursit Ballkanik të Ideve të Gjelbërta 2022, që do të zhvillohet në Shtator, në Shqipëri.
- “Sipërmarrësit e së Nesërme” është projekti që Tirana Bank mbështeti në partneritet me Tirana Business University. Aktiviteti, tashmë traditë dhe me pjesëmarrje të lartë të gjimnazistëve nga i gjithë vendi, u konceptua në dy faza: prezantimin e ideve të gjimnazistëve dhe ndarja e çmimeve fituese. Përfaqësues të lartë të Bankës, ishin pjesë e jurisë së vlerësimit të ideve dhe nderuan fituesit me dy çmime premium.
- Banka organizoi një aktivitet argëtues, dedikuar fëmijëve të stafit, nën tematiken “Le të luajmë së bashku”.
- Tirana Bank kujdeset të krijojë



dhe ruajë marrëdhënien me të rinjtë mes programit Students Hub me fokus në transformimin digjital dhe nën moton Learn By Doing Goes Digital udhëhoqi përvojën unike të "Bankierit Digjital". Studentët e përzgjedhur në këtë program zhvilluan aftësitë e tyre profesionale dhe tre performuesit më të mirë u vlerësuan me çmime në eventin përshëndetës në përmbyllje të programit 3-mujor.

UNIONBANK

- Sponsor zyrtar i Colourday Festival, festivalit rinor më të madh të organizuar në zemër të Tiranës, i cili u zhvillua në datat 11 dhe 12 qershor në sheshin "Nënë Tereza".
- Banka iu bashkua thirrjes për pjesëmarrje në seancën e dhurimit të gjakut në ndihmë të fëmijëve talasemikë. Seanca e dhurimit u realizua në datë 13 qershor pranë ambienteve të Union Bank në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar dhe në asistencën e mjekëve të palodhur të Bankës Kombëtare të Gjakut.
- Në bashkëpunim me Protik Innovation Center organizoi konkursin 3-ditor "Hackathon". Në këtë aktivitet morën pjesë studentë, të cilët patën mundësi të propozojnë idetë e tyre për zhvillimin e sistemeve të bankës

sidhetë njihen nga afër me stafin e profesionistëve nga Union Bank. Projektet e studentëve kaluan në një proces vlerësimi, nga i cili u përzgjedhën dy projekte fituese, të cilat u vlerësuan për originalitetin, zgjidhjen e ofruar si dhe prezantimin e projekt-idesë.

- Union Bank ishte pjesëmarrëse në Panairin "Ditët e Bujqësisë 2022", i cili u zhvillua në qytetin e Lushnjës në datat 19-21 maj 2022.
- "Tinguj Ballkani" spektakli muzikor i mbështetur nga Union Bank i organizuar në datën 11 maj, solli në skenë për publikun e qytetit të Beratit, këngët dhe vallet e Ballkanit nga nxënësit e talentuar të shkollës së mesme artistike "Ajet Xhindole".
- Mbështeti për të dytin vit radhazi aktivitetin "Të drejta të barabarta për mundësi të barabarta" të organizuar nga shoqata "RESS-Egnatia", në bashkëpunim me Bashkinë e Elbasanit dhe Këshillin e Qarkut Elbasan. Ashtu si dhe vitin e kaluar, ky event i organizuar kishte në qendër të tij angazhimin dhe përfshirjen e fëmijëve me çrregullim të spektrit autik (ÇSA) në aktivitete sociale dhe sportive. Rreth 200 fëmijë patën mundësi që për dy ditë rresht të merrnin pjesë në gara sportive dhe lojëra të ndryshme, nën kujdesin e prindërve dhe instruktorëve të specializuar.
- Në bashkëpunim me Protik Innovation Center organizoi një Open Day me studentë të fushës së IT, një mundësi për studentët për t'u njohur gjithashtu me



hapësirat dhe mundësitë e zhvillimit të karrierës që Union Bank ofron.



- Union Bank ka prezantuar Paketën “Harry Fultz” në bashkëpunim me Institutin Harry Fultz, një paketë me produkte dhe shërbime bankare me kushte preferenciale, të dedikuara për nxënësit që kryejnë studimet e tyre pranë këtij institucioni. Në përfundim të aktivitetit, stafi i Union Bank shpërndau për grupin e parë të nxënësve Kartën e Debitit Harry Fultz, e cila ofrohet me zero komision për të gjithë nxënësit.
- Banka ishte pjesëmarrëse në Panairin e Turizmit (ITE Days) i cili u organizua në ambientet e Expocity Albania në datat 2-4 qershor, si dhe në paniret e punës dhe karrierës të organizuar në universitete të ndryshme në Tiranë dhe Durrës (Epoka, FEUT, “Aleksandër Moisiu”, Metropolitan, Kolegji Universitar Qiriaz).
- U realizua projekti i rindërtimit të 4 shtëpive të dëmtuara nga tërmeti i 26 nëntorit 2019 në Njësinë Administrative Ndroq. Ato u rikonstruktuan tërësisht dhe u mobiluan me fondin e akorduar nga Union Bank në bashkëpunim edhe me Bashkinë e Tiranës. Me këtë rast, u organizua inaugurimi i njëjës prej këtyre shtëpive, ku znj. Flutura Veipi, Drejtore e Përgjithshme Ekzekutive e Union Bank dhe znj. Ketil Luarasi, Zv. Kryetare e Bashkisë së Tiranës, të pranishme në këtë inaugurim, dorëzuan çelësin e shtëpisë së re të z. Myslym Korriku.

- UBA Bank, në bashkëpunim me Universitetin “Albukhary” në Malajzi, i kanë mundësuar të gjithë të rinjve shqiptarë aplikim për të studiuar në një nga Universitetet më të mira në Malajzi. Studentit Elton Korpuzi nga Durrësi iu mundësua bursa e plotë e studimit si dhe të gjitha shpenzimet e tjera të nevojshme përgjatë gjithë qëndrimit të studimit të tij në universitet.
- Mbështeti financiarisht “Institutin e Edukimit, të Trashëgimisë dhe Turizmit”, për të bërë të mundur organizimin e konkursit të fotografisë më të mirë me temën “The Treasure of Albania” (Thesari i Shqipërisë), ku fotot më të bukura do të nderohen me çmime, si dhe do të jenë pjesë e botimit të një libri me të njëjtin titull “The Treasure of Albania”.
- Me rastin e muajit të shenjtë të Ramazanit, banka dhuroi pranë Shoqatës “Gjysmëhëna Shqiptare” kontributin e saj për të bërë të mundur dhurimin e 150 shportave me ushqime për familjet shqiptare në nevojë.
- Ndihmoi financiarisht “Komunitetin Mysliman Shqiptar”, për të dhuruar shporta ushqimore për familjet në nevojë, gjithashtu dhe në organizimin e iftareve përgjatë muajit të shenjtë të Ramazanit.

